



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I
MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

PËR

**RAPORTIMIN NË AMF TË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË
ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 25, datë 23.02.2011
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 136, datë 28.09.2017
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 22.01.2020*

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë përmbajtjen, shpeshtësinë, afatet dhe formën e pasqyrave financiare të detyrueshme për tu depozituar nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve, në Autoritet, në lidhje me:

- a. Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese të ndërmjetme, me anë të të cilave shoqëria administruese informon Autoritetin dhe përdoruesit e tjerë të jashtëm në lidhje me gjendjen e saj financiare. (Shtojca 1);
- b. Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese të ndërmjetme të fondit të pensionit, hartuar me qëllim informimin e Autoritetit dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm rreth gjendjes financiare të fondit. (Shtojca 2);
- c. Pasqyrat statistikore vjetore dhe për periudhat raportuese të ndërmjetme të fondit të pensionit hartuar me qëllim informimin e Autoritetit dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm rreth vëllimit të aktivitetit të kryer në periudhën e raportuar. (Shtojca 3).

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 76 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, këtu e më poshtë (“Ligji”).

Neni 3

Përgatitja e pasqyrave financiare

Shoqëria administruese duhet të hartojë dhe të publikojë pasqyra financiare në përputhje me Ligjin dhe me dispozitat ligjore që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.

***Neni 4**

Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese

1. Pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë administruese duhet të përfshijnë:
 - a. Pasqyrën e bilancit;
 - b. Pasqyrën e fitim humbjeve;
 - c. Pasqyrën e fluksit të parasë;
 - ç. Pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit të vet;
 - d. Pasqyra e raportit të kapitalit,
 - dh. Pasqyra detajimi i tarifave;
 - e. Pasqyra e strukturës së aseteve, depozita dhe llogari rrjedhëse;
 - ë. Pasqyra e strukturës së aseteve, Letra me vlerë;
 - f. Pasqyra e strukturës së aseteve, Obligacione qeveritare;
 - g. Pasqyra e strukturës së aseteve, Obligacione te shoqërive dhe;
 - gj. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të vetë shoqërisë administruese janë përcaktuar në Shtojcën 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese depoziton në AMF raportin vjetor të kontrollit të brendshëm në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë dhe fondit të pensionit që ajo administron.

Neni 5

Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të fondit të pensionit

1. Pasqyrat financiare të fondit të pensionit do të përfshijnë:
 - a. Pasqyrën e aseteve të fondit;
 - b. Pasqyrën e veprimtarisë së fondit të pensionit;
 - c. Pasqyrën e ndryshimeve në asetet neto;
 - ç. Pasqyrën mbi kuotat e fondit të pensionit;
 - d. Pasqyrën e strukturës së investimeve me të gjitha pasqyrat përbërëse të saj;

- i. letrat me vlerë të listuara;
 - ii. obligacionet;
 - iii. letra me vlerë të tjera;
 - iv. depozitat me afat;
 - v. investime të tjera;
 - vi. treguesit e portofolit.
- e. Pasqyrën e fitimeve (humbjeve) të realizuara të fondit;
 - f. Pasqyrën e fitimeve (humbjeve) të perealizuara të fondit;
 - g. Tabela e planeve të pensionit;
 - h. Tabela e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit;
 - i. Tabela e numrit të anëtarëve të larguar nga fondi i pensionit;
 - j. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit sipas grupmoshave;
 - k. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit;
 - l. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të fondit të pensionit janë përcaktuar në Shtojcën 2, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Periudhat e hartimit të pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare të cituara më sipër në nenet 4 dhe 5 do të përpilohen për vitin ushtrimor për gjendjen më 31 dhjetor dhe për nën-periudha gjatë vitit ushtrimor për gjendjen më 31mars, 30 qershor dhe 30 shtator të vitit ushtrimor.
2. Shënimet në pasqyrat financiare për periudhat ndërmjetëse gjatë vitit ushtrimor duhet të paraqesin vetëm ngjarjet e rëndësishme të veprimtarisë dhe ndryshimet në politikat kontabël në lidhje me pasqyrat më të fundit financiare vjetore të publikuara.

***Neni 7**

Afatet për depozitim

1. Shoqëria administruese duhet të depozitojë pasqyrat financiare vjetore të paaudituar si dhe për nën periudhat raportuese të vitit ushtrimor për fondin e pensionit dhe për shoqërinë administruese deri më datë 15 të muajit pas përfundimit të periudhës raportuese.
2. Shoqëria administruese duhet të depozitojë pasqyrat financiare vjetore të audituara të fondit të pensionit dhe të shoqërisë administruese deri më 30 prill të vitit pasardhës.

3. Shoqëria administruese depoziton në AMF raportin vjetor të kontrollit të brendshëm brenda muajit janar të çdo viti pasardhës.

***Neni 8**

Mënyra e depozitimit

1. Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit duhen të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim brenda afateve të referuara në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria administruese duhet të depozitojë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të referuar në nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:
 - a. Pasqyrat e audituara financiare vjetore të shoqërisë administruese dhe të fondit të pensionit;
 - b. Raportin nga eksperti kontabël i regjistruar për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë administruese dhe të veprimtarisë së fondit të pensionit, dhe
 - c. Raportin vjetor të shoqërisë administruese.

Neni 9

Hartuesi dhe depozituesi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese është përgjegjëse për hartimin dhe depozitimin e të gjitha pasqyrave financiare të fondit të pensionit dhe të veprimtarisë së shoqërisë administruese siç përcaktohen në shtojcat 1 dhe 2, si edhe për hartimin dhe depozitimin e informacioneve shtesë që mund të kërkojë Autoriteti në lidhje me fondin e pensionit dhe/ose veprimtarinë e shoqërisë administruese.
2. Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit duhet të jenë të firmosura nga Drejtori i financës dhe Administratori i shoqërisë administruese.

Neni 10

Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese duhet të mbajë libra kontabël, dhe të hartojë e publikojë pasqyrat financiare për fondin e pensionit që administron në përputhje me ligjin dhe me dispozitat që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.

2. Pasqyrat vjetore financiare të fondit të pensionit duhet të auditohen nga ekspertë kontabël të regjistruar.

Neni 11

Publikimi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese duhet të publikojë pasqyrat e saj vjetore financiare të audituara dhe pasqyrat vjetore financiare të fondit të pensionit që administron në mënyrën e parashikuar nga ligji dhe ato akte që rregullojnë kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.
2. Shoqëria administruese duhet të mbajë të publikuara në faqen e saj të internetit, pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit për periudhat raportuese të ndërmjetme gjatë vitit ushtrimor.

Neni 12

Pasqyrat statistikore

1. Shoqëria administruese është përgjegjëse për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave statistikore të fondit të pensionit.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave statistikore të fondit të pensionit përcaktohet në Shtojcën 3, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese duhet të depozitojë pasqyrat statistikore të fondit të pensionit për periudhat raportuese të ndërmjetme brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo periudhe të raportimit.

***Neni 13**

Dispozita Kalimtare

Për periudhat financiare deri në 31.12.2020, shoqëritë administruese përveç formave të raportimit të përmendura në këtë rregullore do të vazhdojnë të raportojnë dhe në formatin Excel me email pranë departamentit përkatës të gjithë raportet e përfshira në shtojcat 1 dhe 2.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

Shtojca 1 - Pasqyrat financiare së shoqërisë administruese të fondit të pensionit

Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	
Adresa	
Telefon dhe fax.	
E-mail:	
Faqe Web	
Data e licencimit	
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	
Pesë aksionarët më të mëdhenj (emri, mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Numri i punonjësve	
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administrimit	
Numrat e llogarisë	

SHTOJCA 1 – Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese*1. Pasqyra e Bilancit*

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për datën: _____

AKTIVI	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)		
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)		
1. Toka dhe Ndërtesa		
2. Të tjera aktive afatgjata materiale		
II. Aktive jo-materiale		
III. Aktive financiare(1+2+3+4)		
1. Depozita bankare		
2. Të vlefshme për shitje		
3. Të mbajtura deri në maturim		
4. Të tjera aktive financiare afatgjata		
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto		
B. Aktiv tatimor i shtyrë		
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI)		
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera		
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)		
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensione		
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim.		
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera		
4. Të tjera llogari të arkëtueshme		
III. Aktive financiare (1+2+3+4)		
1. Depozita bankare		
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të vlefshme për shitje		
3. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura deri në maturim		
4. Kuota në fonde investimi		
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)		
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë		
2. Mjete monetare në arkë		
V. Shpenzime të parapaguara		
VI. Të ardhura të llogaritura		
D. Totali i Aktiveve(A+B+C)		

PASIVI	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)		
I. Kapitali i nënshkruar		
II. Rezerva të kapitalit		
III. Rezerva e rivlerësimit		
IV. Rezerva të tjera		
V. Fitime / humbje të mbartura		
VI. Fitimi /humbja neto për periudhën		
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)		
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit/investimit		
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi		
III. Detyrime të tjera afatgjata		
C. Detyrim tatimor i shtyrë		
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe		
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)		
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit/investimit		
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi		
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme		
IV. Shpenzime të shtyra		
V. Të ardhura të marra në avancë		
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)		

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
I. Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)		
1.Tarifa të administrimit		
2.Tarifa të largimit nga fondi		
3.Tarifa të tjera		
II. Shpenzime nga administrimi i fondit (1+2+3+4)		
1.Shpenzime të transaksioneve		
2. Shpenzime të marketingut		
3. Shpenzime të shitjes me agjent		
4. Shpenzime të tjera të administrimit të fondit		
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit/investimit (+/-) (I - II)		
IV. Të ardhura të tjera		
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)		
1. Shpenzime për materiale		
2. Shpenzime për personelin		
Amortizim i aktiveve materiale afatgjata/jo materiale		
3. afatgjata		
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afatshkurtra		
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe		
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë		
VI. Të ardhura financiare		
VII. Shpenzime financiare		
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)		
IX. Tatimi mbi fitimin		
X. Fitim / Humbja neto për periudhën (VIII-IX)		

3. Pasqyra e Fluksit të Parave

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha e raportimit
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese		
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese		
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)		
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese		
e. Pagesa për veprimtarinë investuese		
f. Flukse monetare neto nga veprimtaria investuese (d - e)		
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese		
h. Pagesa për veprimtarinë financuese		
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)		
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (c+f+i)		
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël		
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)		

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

Emri i shoqërisë së administrimit: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

Ndryshime në Kapital	Data e vitit paraardhës	Rritje	Zbritje	Data e vitit ushtrimor
I. Kapitali i nënshkruar				
II. Prime për aksione të emetuara				
III. Rezerva e rivlerësimit				
IV. Rezerva të tjera				
V. Fitime (humbje) të mbartura				
VI. Fitimi (humbja) e periudhës ushtrimore				
VII. Pagesat e dividendit				
VIII. Ndryshime në politikat kontabël dhe korigjime				
IX: Ndryshime të tjera në kapital				
TOTALI I KAPITALIT (I+II+III+IV+V+VI+VII+VIII+IX)				

*Në sistem nuk do shfaqet kolona e periudhës së mëparshme të raportimit. Shoqëritë do plotësojnë të dhënat për periudhën aktuale të raportimit.

5. Pasqyra raporti i kapitalit

Emri i shoqërisë së administrimit: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

Emërtimi	Vlera
Kapitali fillestar	
Më pak ose i barabartë me	
Asete nën administrim	
Diferenca	
Rritja me 0.02% të tejkallimit	
Kërkesa ligjore e kapitalit	

6. Pasqyra detajimi i tarifave

Emri i shoqërisë së administrimit: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

Emërtimi i fondit	Lloji i fondit	Tarifa e administrimit

7.1 Pasqyra e strukturës së aseteve, depozita dhe llogari rrjedhëse

Emri i shoqërisë së administrimit: _____

Kodi i shoqërisë:
Për periudhën:

Pozicioni	Referenca	Maturiteti	Vlera në momentin e depozitimit	Vlera në datën e raportimit
Depozita afatshkurtër				
Depozita afatgjatë				
Llogari rrjedhëse				

7.2 Pasqyra e strukturës së aseteve, Letra me vlerë

Emri i shoqërisë së administrimit:

Kodi i shoqërisë:

Për periudhën:

Pozicioni	ISIN	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Bono thesari vendase					
Emetime te Bankës Qendrore Vendase					
Dëftesa tregtare vendase					
Kuota në fonde vendase					
Letra te tjera me vlere vendase					
Bono thesari te huaja					
Emetime te Bankës Qendrore te Huaj					
Dëftesa tregtare te huaja					
Kuota në fonde të huaja					
Letra me vlerë të tjera të huaja					
Totali vendase					
Totali të huaja					

7.3 Pasqyra e strukturës së aseteve, Obligacione qeveritare

Emri i shoqërisë së administrimit:

Kodi i shoqërisë:

Për periudhën:

Pozicioni	ISIN	Qëllimi i Mbajtjes	Shteti	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione të qeverisë vendase							
Obligacione bashkiake vendase							
Obligacione të qeverisë të huaja							

7.4 Pasqyra e strukturës së aseteve, Obligacione të shoqërive

Emri i shoqërisë së administrimit:

Kodi i shoqërisë:

Për periudhën:

Pozicioni	ISIN	Qëllimi i Mbajtjes	Shoqëria	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione shoqërishe vendase							
Obligacione shoqërishe të huaja							

8. Shënime të pasqyrave financiare

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë: _____

Për periudhën: _____

Shënimet për pasqyrat financiare do të përgatiten në përputhje me kërkesat e SNRF-ve dhe do të:

- a. Paraqesin informacion rreth bazës së përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike të kontabilitetit të përdorura, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 (IAS1);
- b. Ekspozojnë çdo informacion të kërkuar nga SNRF-të që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare;
- c. Paraqesin informacion shtesë që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare por që është i rëndësishëm për të kuptuar secilën prej tyre.

Data e raportimit:

Personi i autorizuar i shoqërisë:

Përgatitur nga:

Detaje kontakti:

Shtojca 2 - Pasqyrat financiare të fondit të pensionit

*1. Pasqyra e aseteve të fondit të pensionit.

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Zërat e aktivit	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		
Investime (2.1+2.2+2.3)		
2.1 Letra borxhi të blera në emetimin e parë (2.1.a+2.1.b+2.1.c)		
2.1.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.1.b. Investime financiare të vlefshme për shitje		
2.1.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2.2 Letra borxhi të blera në treg sekondar (2.2.a+2.2.b+2.2.c)		
2.2.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.2.b. Investime financiare të vlefshme për shitje		
2.2.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2.3 Depozita		
3. Llogari të arkëtueshme		
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme		
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE		
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese		
7. Detyrime ndaj depozitarit		
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë		
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera		

B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE		
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT		
D NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT E		
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT		

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

		Lekë	Lekë
Nr.	Zërat e aktivitetit	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë		
2	Të ardhura nga interesat		
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Të ardhura nga interesat e depozitave		
6	Të ardhura të tjera		
A (1+2+3+4+5+6)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET		
	SHPENZIMET		
7	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë		
8	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
9	Tarifa për shoqërinë administruese		
10	Tarifa për depozitarin		
11	Shpenzime të tjera/provigjone		
B (7+8+9+10+11)	TOTALI I SHPENZIMEVE		
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-		
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e parealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-		
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë		
d3	Amortizimi i primit/diskountit të aktiveve me afat maturimi fiks.		
d4	Zhvlerësim i aktiveve		
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-		
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		

F	TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE		
	Zërat që mund të klasifikohen më pas në fitim ose humbje:		
	Letra të vlefshme për shitje:		
	Fitim/humbjet që lindin gjatë vitit nga letrat e vlefshme për shitje		
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Nr.	Zërat e aktivitetit	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1 (nga FPF 2C)	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-		
2 (nga FPF 2 D)	Totali i fitimeve (humbjeve) të përealizuara nga investimet në letra me vlerë, +/-		
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje		
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
4	Kontribute nga anëtarët e fondit		
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të Anëtarësisë (-)		
6	Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit (-)		
7	Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor (-)		
8	Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të Pensionit (-)		

B (4+5+6+7+8)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E PENSIONIT, +/-		
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-		
D	AKTIVET NETO		
9	Në fillim të periudhës		
10	Në fund të periudhës		
	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		
11	Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e kontributeve		
12	Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (-)		
13	Kuota për tërheqjet e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit /e parakohshme (-)		
14	Kuota të tërheqjeve të pensioneve mujore (-)		
15	Kuota të tërheqjeve të pensionit në mënyrë të menjëhershme (-)		
E (11+12+13+14+15)	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Lloji	Numri i kuotave të fondit	Aktivitet e fondit (Lekë)	Aktive për kuotë (Lekë)
Në fillim të periudhës			
Emetuar gjatë periudhës			
Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë			
Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit (tërheqje të parakohshme)			
Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor			
Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të pensionit			
Në fund të periudhës			

*Në sistem nuk do shfaqet kolona e periudhës së mëparshme të raportimit. Shoqëritë do plotësojnë të dhënat për periudhën aktuale të raportimit.

5. Pasqyra e strukturës së investimeve
5.1.Letrat me vlerë të listuara

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Lloji	Numri i aksioneve	Shpenzimet e blerjes për aksion (Lekë)	Shpenzime të blerjes në total (Lekë)	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Vlera për aksion (Lekë)	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Fonde të indeksuara (brenda vendit)							
Letra të tjera me vlerë (brenda vendit)							
TOTALI (BRENDA VENDIT)							
Fonde të indeksuara (jashtë vendit)							
Letra të tjera me vlerë (jashtë vendit)							
TOTALI (JASHTË VENDIT)							

5.2. *Pasqyra e strukturës së investimeve, Obligacionet

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

	Vlera nominale (Lekë)	Shpenzimet e blerjes (Lekë)	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Lloji					
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)					
Të mbajtura deri në maturim (HTM)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Me qëllim tregtimin (HFT)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Të vlefshme për shitje (AFS)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE VENDAS					

Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)					
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)					
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ					

5.3. *Pasqyra e strukturës së investimeve, Letrat me vlerë të tjera*

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Lloji	Vlera nominale (Lekë)	Shpenzimet e blerjes (Lekë)	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Bono të thesarit (brenda vendit)					
Letra me vlerë të tjera (brenda vendit)					
TOTALI I LETRAVE TË TJERA ME VLERË TË EMETUESVE VENDAS					
Bono të thesarit (jashtë vendit)					
Letra të tjera me vlerë (jashtë vendit)					
TOTALI I LETRAVE TË TJERA ME VLERË TË EMETUESVE HUAJ					

5.4. Pasqyra e strukturës së investimeve, depozitat me afat

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Lloji	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Depozita afatshkurtër (> 3 muaj dhe < = 1 viti)		
Depozita afatgjatë (> 1 viti)		
Depozita të tjera (<= 3 mujore)		
TOTALI I DEPOZITAVE		

5.5. *Pasqyra e strukturës së investimeve, investime të tjera*

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (brenda vendit)		
Aktive të tjera (brenda vendit)		
TOTALI BRENDË VENDIT		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (jashtë vendit)		
Aktive të tjera (jashtë vendit)		
TOTALI JASHTË VENDIT		

6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Treguesit e portofolit të fondit të pensionit									
Vlera totale e aseteve të fondit: Lekë									
Struktura e aseteve	Total	Deri në 1 muaj	>1 muaj deri 3 muaj	>3 muaj deri 6 muaj	>6 muaj deri 1 vit	>1vit deri 3 vjet	>3 vjet deri 5 vjet	>5 vjet deri 7 vjet	>7 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentë	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Depozita bankare	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Bono thesari RSH	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Obligacione qeveritare RSH	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Obligacione qeveritare jashtë vendit	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Obligacione të korporatave	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Asete të tjera	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Total Portofoli i investimeve	Vlera (lekë)								
	Në %	%	%	%	%	%	%	%	%
Kthyeshmëria									
Modified Duration									

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara të fondit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Letra me vlerë të shitura	ISIN	Data e shitjes	Numri i letrave me vlerë	Vlera kontabël (Lekë)	Çmimi i shitjes (Lekë)	Fitimi (Humbja) e realizuar (Lekë)
Obligacione të Qeverisë:						
HTM						
HFT						
AFS						
Bono të thesarit						
Obligacione të shoqërive						
Fonde të indeksuara						
Letra me vlerë të tjera						
Totali						

8. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të perealizuara të fondit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Letra me vlerë	ISIN	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes (Lekë)	Vlera e tregut (Lekë)	Fitimi i perealizuar nga ndryshimi i çmimit (Lekë)	Ndryshimi neto në vlerën e investimit nga kursi i këmbimit (Lekë)	Amortizimi i primit / diskountit të aktiveve me afat maturimi fiks (Lekë)	Zhvlerësim i aktiveve (Lekë)
Obligacione të Qeverisë								
HTM								
HFT								
AFS								
Bono të thesarit								
Obligacione të shoqërive								
Fonde të indeksuara								
Letra me vlerë të tjera								
Totali								

9. *Tabela e planeve të pensionit*

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Planet e pensionit	Nr.
numri i planeve individuale të pensionit	
numri i planeve profesionale të pensionit (kontrata punonjës-shoqëri administruese)	
numri i planeve të pensionit të krijuara nga subjektet (kontrata subjekte-shoqëri administruese)	

10. *Tabela e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit*

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Anëtarë sipas planeve të pensionit	Nr. i anëtarëve
anëtarë në planet individuale	
anëtarë në planet profesionale	
Anëtarë gjithsej	

11. *Tabela e numrit të anëtarëve të larguar nga fondi i pensionit*

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

	Nr. i anëtarëve të larguar nga fondi	Nr.
1.	për shkak se ka lindur e drejta për përfitim pensioni (tërheqje e menjëhershme e pensionit)	
2.	për shkak se ka lindur e drejta për përfitim pensioni (tërheqje periodike e pensionit)	
3.	për shkak të largimeve të parakohshme	
4.	për shkak të ndryshimit të anëtarësisë	
	Totali (1+3+4)	

12. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit sipas grupmoshave

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Ndarja e anëtarëve sipas grupmoshave	Nr. i anëtarëve
< 25 vjeç	
25 vjeç - 30 vjeç	
30 vjeç - 40 vjeç	
40 vjeç - 50 vjeç	
50 vjeç - 60 vjeç	
> 60 vjeç	
Anëtarë pa moshë të identifikuar	
Total	

13. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____
 Kodi i fondit të pensionit: _____
 Emri i shoqërisë administruese: _____

Gjendja e kontributeve të klientëve deri më (periudha aktuale) (në Lekë)	Vlera në Lekë
Nga anëtarë vullnetarë	
Punonjës + Punëdhënës	
Totali	
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	
Kontributet e punonjësve	
Totali	

Kontribute të derdhura nga fillim viti - periudha aktuale (në Lekë)	Vlera në Lekë
Nga anëtarë vullnetarë	
Punonjës + Punëdhënës	
Totali	
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	
Kontributet e punonjësve	
Totali	

14. Shënime të pasqyrave financiare të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Shënimet për pasqyrat financiare do të përgatiten në përputhje me kërkesat e SNRF-ve dhe do të:

1. Paraqesin informacion rreth bazës së përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike të kontabilitetit të përdorura, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 (IAS1);
2. Ekspozojnë çdo informacion të kërkuar nga SNRF-të që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare;
3. Paraqesin informacion shtesë që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare por që është i rëndësishëm për të kuptuar secilën prej tyre.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Vullnetar _____
 INFORMACION STATISTIKOR 3-MUJOR DHE
 PROGRESIV

Periudha 3m _____

Viti _____

Nr.	Përshkrimi	Periudha 3-mujore	Periudha Progresive
I	Numri i fondeve nën administrim ($a+b+c$)		
	a.fond pensioni vullnetar		
	b.fond pensioni profesional		
	c.fond pensioni mix		
II	Numri i anëtarëve ($a+b+c$)		
	në fillim		
	a.fond të rinj		
	pensionimi të		
	vullnetar transferuar		
	të larguar		
	Gjithsej (a)		
	<i>nga të cilët: llogari jo aktive</i>		
	në fillim		
	b.fond të rinj		
	pensionimi të		
	profesional transferuar		
	të larguar		
	Gjithsej (b)		
	<i>nga të cilët: llogari jo aktive</i>		
	në fillim		
	c.fond të rinj		
	pensionimi të		
	mix transferuar		
	të larguar		
	Gjithsej (c)		
	<i>nga të cilët: llogari jo aktive</i>		
III	Numri i anëtarëve ($a+b+c$)		
	a.fond femra		
	pensionimi meshkuj		
	vullnetar femra		
	b.fond femra		
	pensionimi meshkuj		
	profesional		

		c.fond pensioni mix	femra meshkuj		
IV	Numri mesatar i kuotave për anëtar	a.fond pensioni vullnetar			
		b.fond pensioni profesional			
		c.fond pensioni mix			
V	Numri total i kuotave	a.fond pensioni vullnetar			
		b.fond pensioni profesional			
		c.fond pensioni mix			

(Emri, Mbiemri, firma dhe vula e shoqërisë)

Shënime:

** Seksionet II - V duhet të plotësohen për çdo fond pensioni më vete.*

*** Plotësoni periudhën sipas sipas shembullit në vijim: Periudha 3m, Prill-Qershor*

Periudha Progressive, Janar-Qershor

Viti 2011

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Vullnetar
INFORMACION STATISTIKOR DHE FINANCIAR 3-MUJOR DHE
PROGRESIV

Periudha 3m _____

Viti _____

Nr.	Përshkrimi	Periudha 3-Mujore				Periudha Progressive			
		Total (në Lekë)	Vlera (në Lekë)	Vlera (në Euro)	Vlera (në USD)	Total (në Lekë)	Vlera (në Lekë)	Vlera (në Euro)	Vlera (në USD)
I	Të ardhura nga kontributet (a+b+c)								
	a.fond pensioni vullnetar								
	Gjithsej (a)								
	b.fond pensioni profesional								
	kontributi i anëtarëve kontributi i punëdhënësit								
	Gjithsej (b)								
	c.fond pensioni mix								
	kontributi i anëtarëve kontributi i punëdhënësit								
II	Vlera mesatare për kuotë								
	a.fond pensioni vullnetar								
	b.fond pensioni profesional								
	c.fond pensioni mix								
III	Pagesa pensioni (a+b+c)								

	a.fond pensioni vullnetar	1. i plotë							
		2.iparakoshëm							
		3. invaliditet i përhershëm							
		4. tërheqje parakohshme							
		Gjithsej (a)							
	b.fond pensioni profesional	1. i plotë							
		2.iparakoshëm							
		3. invaliditet i përhershëm							
		4. tërheqje parakohshme							
		Gjithsej (b)							
	c.fond pensioni mix	1. i plotë							
		2.iparakoshëm							
		3. invaliditet i përhershëm							
		4. tërheqje parakohshme							
		Gjithsej (c)							
IV	Transferimi i aseteve (a+b+c)								
	a.fond pensioni vullnetar								
	b.fond pensioni profesional								
	c.fond pensioni mix								

Ky formular raportohet çdo 3-mujor dhe në mënyrë progresive e depozitohet në AMF brënda datës 15 të muajit pasardhës.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

(Emri, Mbiemri, firma dhe vula e shoqërisë)